

VENDIM
Nr. 169, datë 15.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1564/2 prot., datë 10.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1564/1 prot., datë 26.5.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 492, seria F21, është 2.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 2.6.2026.

- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/depozitojë dhe sa vijon:

- informacion mbi stafin teknik aktualisht efektiv;
- vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj;

- mbështetjen financiare për vlerën e mbetur për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike, dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin përkatës të shumës për secilën veprimtari sipas përlllogaritjeve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 492, seria F21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti